



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2026
01 NR/BR.	204/ 26

PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/THROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Ferizajt.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Propozim - Vendim për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Ferizajt.

A r s y e t i m

Qëllimi i kësaj rregullore është rregullimi i çështjës së menaxhimit të mbeturinave dhe përcaktimi i taksës për mbeturina bazuar në Ligjin 03/L-049 për Financat e Pushteti Lokal. Me këtë rregullore krijohen kushtet për menaxhimin të integruar dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar të mbeturinave dhe uljen e shkallës së rrezikshmërisë nga mbeturinat.

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat administrative për menaxhimin e mbeturinave të Komunës së Ferizajt.

Komuna e Ferizajt, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, ka përfunduar të gjitha procedurat edhe të konsultimit publik, andaj propozoj që ky dokument të miratohet.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2026
01 NR/BR.	204/ 26

PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Ferizajt.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina , Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Propozim - Vendim për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Ferizajt.

A r s y e t i m

Qëllimi i kësaj rregullore është rregullimi i çështjës së menaxhimit të mbeturinave dhe përcaktimi i taksës për mbeturina bazuar në Ligjin 03/L-049 për Financat e Pushteti Lokal. Me këtë rregullore krijohen kushtet për menaxhimi të integruar dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar të mbeturinave dhe uljen e shkallës së rrezikshmërisës nga mbeturinat.

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat administrative për menaxhimin e mbeturinave të Komunës së Ferizajt.

Komuna e Ferizajt, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, ka përfunduar të gjitha procedurat edhe të konsultimit publik, andaj propozoj që ky dokument të miratohet.

**RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE
NË KOMUNËN E FERIZAJT**

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e secilit ndaj mjedisit jetësor, të përcaktuar në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas nenit 12.2(c), 17(f), dhe 40.2(a) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare 28/04 Qershor 2008), të nenit 13 pika 1.2 lidhur me nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-060, për Mbeturina (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2012), dhe nenit 25 pika 2.1 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt mbledhjen e mbajtur më datë 00.00.2026, miratoj këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNEN E FERIZAJT

Neni 1

QËLLIMET DHE DETYRAT

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i çështjes së menaxhimit të mbeturinave komunale dhe përcaktimi i taksës për mbeturina, bazuar në Ligin nr' 03/L-049' për financat e pushtetit lokal (nene 13, L3'1 dhe 15' pika f).
2. Me këtë rregullore krijohen kushtet për menaxhimin të integruar dhe zvogëlimin e sasise së prodhuar të mbeturinave dhe uljen e shkallës së rrezikshmërisë nga mbeturinat.

Neni 2

PERKUFIZIMET

1. **Mbeturina** - nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.
2. **Menaxhim i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndet të njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
3. **Operator** - nënkupton personin, i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave, si dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
4. **Licenca**- për menaxhimin e mbeturinave - nënkupton leje me shkrim, e cila jepet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas ligjeve në fuqi.
5. **Person** - nënkupton personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
6. **Ripërdorim** - nënkupton çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.
7. **Mbledhje** - nënkupton mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe organizimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

8. **Mbledhje e ndarë** - nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.
9. **Prodhuesi i mbeturinës** - nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon / prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me para-procesim, përziere apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen mbeturinës.
10. **Zotëruesi i mbeturinës** - nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën.
11. **Mbeturina komunale** - nënkupton mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
12. **Mbeturina e parrezikshme** - nënkupton mbeturinat që nuk paragesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
13. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që perdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit por nuk përfshihen mbeturinat industriale.
14. **Mbeturina inerte** - nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:
 - Mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
 - I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore.
15. **Mbeturinë e vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë
16. **Qendra grumbulluese** - nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

Neni 3

LLOJET E MBETURINAVE

1. Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregullore janë si në vijim:
 - a. Mbeturinat komunale - janë mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre mund të jenë të ngjashme me ato të amvisërisë
 - * Mbeturinat inerte - që nuk treten, nuk ndizen dhe nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike që nuk kanë zbërthim biologjik në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
 - * Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobile
 - * Mbeturina nga konstruktim - demolimet dhe mbeturina të tjera të gjeneruara nga aktivitetet

ndërtimore

- * Biombeturina- janë mbeturina biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.
- b. Mbeturina komercial - janë mbeturinat të cilat gjenerohen nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit sportit edukimit rekreacionit por që nuk përfshihen në mbeturina industriale;
Mbeturina industriale-janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitet, proceset industriale prodhimit artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese
- d. Mbeturina medicinale - janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;
Mbeturinat shtazore - janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishoret dhe aktivitet e tjera të ngjashme.

Neni 4

PËRJASHTIMET

1. Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
 - a) mbeturinat e rrezikshme dhe
 - b) Ilumi / balta dhe mbeturina të ngjashme
2. Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të udhëzimeve perkatese të veçanta administrative

Neni 5

PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1. Themelimi i Sektorit për menaxhimin e mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (DSHPE) që të planifikojë, rregullojë, udhëheqë dhe të zbatojë aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave brenda territorit të komunes si dhe të udhëzojë dhe monitorojë ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave;
2. Trajtimi i mbeturinave komunale nga konstruktiv - demolimi, si dhe i mbeturinave inerte komerciale të vëllimshme brenda territorit të komunës;
3. Zgjedhja dhe caktimi i vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimi i hapësirave për ndërtim të gendrave me të mëdha për grumbullimin e tyre në vendbanimet periferike të qytetit apo edhe ato rurale;
4. Përcaktimi i lokacioneve për vendosjen e kontejnerëve bëhet nga ana e komunës ë bashkëpunim me operatorin ose palët e treta të kontraktuara;
5. Përcaktimi i lokacioneve të kontejnerëve për vendbanimet kolektive bëhet brenda

- hapësires së objektit kolektiv;
6. Ndarja e territorit në zona të shërbimit për mbledhjen e mbeturinave në komunën e Ferizajt
 7. Përcaktimi i llojit të kontejnerëve të përshtatshëm me tekniken me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre;
 8. Përcaktimi i orarit dhe dinamikës së mbledhjes së mbeturinave, përmes planit të ri operative të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave;
 9. Autorizimi i operatorit që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës;
 10. Monitorimi mjedisor i deponisë së mbeturinave;
 11. Identifikimi i pikave / deponive ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe largimi / eliminimi i tyre;
 12. Formimi i komisionit në kuadër të Administratës Komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të tarifpaguesve për mbeturina;
 13. Sigurimi i kushteve të veprimit dhe operimit për operatorët publikë dhe private;
 14. Përcaktimi i taksës dhe mënyrës së arkëtimit të mjeteve financiare nga komuna e Ferizajt;
 15. Promovimi për minimizimin e mbeturinave (ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostim etj):
 16. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;
 17. Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave dhe shkallën e arkëtimit të taksës për mbeturina;
 18. Dorëzimi i raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për menaxhimin e mbeturinave çdo 31 mars të vitit pasues;
 19. Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);
 20. Hartimi i raportit vjetor për realizimin e planit për menaxhimin e mbeturinave deri më 31 mars të vitit vijues;
 21. Futja në sistemin e menaxhimit - grumbullimit të mbeturinave për të gjitha ekonomitë familjare, bizneset etj, brenda territorit të komunës së Ferizajt.
 22. Menaxhimi i mbeturinave në raste emergjente dhe aktiviteteve tjera.

Neni 6

KATEGORIZIMI I GJENERUESVE TË MBETURINAVE

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

A — kategoria e amvisërive, të ndara në nënkategori:

- (1) A-1 - nënkategoria e parë, përfshin klientët e shërbyer vendbanime urbane dhe rurale - derë më derë, dhe
- (2) A-2 - nënkategoria e dytë, përfshin klientët e shërbyer me kontejnerë të perbashkët, në vendbanime urbane dhe rurale;
- (3) A-3 – përfshinë klientët nga Mërgata (Paushall), të cilëve i'u kryhen shërbimet e mbeturinave gjatë kohës sa qëndrojnë në pushime, në çdo periudhë kohore të vitit;
- (4) A-4 – përfshinë tarifën për shtëpitë ose njësitë banesore që janë të regjistruara dhe të gatshme për shfrytëzim, por që janë të pabanuara për arsye dhe rrethana të ndryshme

K — kategoria e klientëve komercialë e industriale, të ndarë në nënkategori:

K-1 — nënkategoria e parë, përfshin veprimtaritë e vogla zejtare dhe sherbyese, si për shembull:

- (a) Kioskat, shitoret dhe dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave;
- (b) shitoret e dyqanet e vogla, siç janë shitesit e kafes, disqeve, kozmetikës, syzeve e thjerrëzave dhe suvenireve; argjendarite, orëtarët, agjencite turistike, rrobageshit, këpucëtarët, fotografet, butiket, libraritë, dyqanet e pastrimit kimik, gurgdhendësit, saraçmbathtarët, këmbimoret, llamarinë-punuesit dhe axhustatorët;
- (c) zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi deri në 20 m³, siç janë zyrat e vogla të avokateve, noterëve, permbaruesve, këshilltarëve financiarë dhe organizatave jogeveritare;
- (d) veprimtari tjera të vogla, siç janë parkingjet, qendrat e videolojerave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjise; dhe
- (e) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë; dhe

K-2 — nënkategoria e dytë, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të ulët të shërbimit, si për shembull:

- (a) lokalet për shitjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve, duke përfshirë auto ngjyrosësit;
- (b) frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal;
- (c) barnatoret, klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karrige;
- (d) serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike;
- (e) shitoret e vogla, përfshirë shitoret sanitare, të mobilie, autopjesëve, tekstilit dhe këpucëve; dhe
- (f) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe lokale me mbi 20 m³;

K-3 — nënkategoria e tretë, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit, si për shembull:

- (a) furrat e bukës dhe byrekoret;
- (b) kafeteritë, lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë;
- (c) shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve;
- (d) bankat;
- (e) sallonet e sanitarisë, sallonet e mëdha të mobilie;
- (f) qendrat sportive dhe të fitnesit;
- (g) veprimtaritë zejtare më të rënda, si auto ngjyrosësit;
- (h) spitalet, poliklinikat, ambulancat specialistike dhe ambulancat stomatologjike me mbi dy karrige;
- (i) bujtinat;
- (j) pompat e benzinës; dhe
- (k) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave gjenerojnë (xhamaprerësit);

K-4 — nënkategoria e katërt, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të lartë të shërbimit, si për shembull:

- (a) shitoret e mëdha;
- (b) restorantet, përfshirë gjelltorët, qebaptoret dhe lokalet e ushqimit të shpejtë;
- (c) klubet e natës;
- (d) veprimtaritë hoteliere;

(e) pompat e benzinës me restorant; dhe

(f) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë; dhe

K-5 — nënkategoria e pestë, përfshinë subjektet komerciale e industriale të shërbyera me kontratë të veçantë; dhe

I - kategoria e klientëve institucionalë, që shërbehen me kontratë të veçantë dhe ndahen në nënkategori:

I-1 — nënkategoria e institucioneve komunale, përfshinë institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme, qendrat kryesore të mjekësisë familjare, bashkësitë lokale, zyrat e vendit, objektet e komunës, teatrot dhe kinematë komunale, objektet kulturore, objektet sportive, zjarrfikësit dhe bashkësitë fetare; dhe

I-2 — nënkategoria e institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare, përfshinë institucionet e nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor, policinë, ndërmarrjet publike, postën, gjykatat, prokurorinë, agjencitë e pavarura, qendrat për punë sociale, zyrat e tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës, perfaqësitë diplomatike e konsullore dhe përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare.

1.2 Gjeneruesit e nënkategorive K-5, I-1 dhe I-2 shërbehen me kontejnerë 1,1 ose 5 metër kub. Gjeneruesit duhet të kenë hapësirë brenda premisave të tyre për të vendosë kontejnerët.

I-3 — në kuadër të kësaj nënkategorie, Kompanisë së licencuar për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, i lejohet të lidhë kontrata të veçanta me çmime të ndryshme, varësisht prej vëllimit të mbeturinave që biznesi krijon, madhësinë e biznesit, vendndodhjes dhe frekuentimit si dhe kostos së shërbimeve

Neni 7

T Ë DREJTAT E GJENERUESVE T Ë MBETURINAVE

1. Te gjithë personat fizikë dhe juridikë që krijojnë mbeturina kanë të drejte të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave.
2. Çdo gjenerues i mbeturinave komunale ka të drejtë ankese ndaj shërbimit të ofruar.

Neni 8

DETYRIME T Ë GJENERUESVE T Ë MBETURINAVE

1. Gjeneruesit e mbeturinave duhet të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të taksës / tarifës së miratuar nga Komuna.
2. T ë gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
3. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
- a. Gjeneruesit e mbeturinave duhet pasur së paku dy kontejnerë për hedhjen e mbeturinave të ndara

- b. Hedhja e mbeturinave shtëpiake, nga gjeneruesit në objekte të banimit kolektiv bëhet në kontejnerë ose në vendet për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave.
4. Gjeneruesit e mbeturinave të veçanta, si spitalet, ambulancat dhe objektet e tjera për shërbime mjekësore, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera.
5. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara.
6. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet ti respektojë rregullat e percaktuara sipas planit të MMN-së
7. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes kompostimit dhe formave të tjera të mundshme).
8. Çdo gjenerues obligohet që t'i largojë mbeturinat që krijohen gjatë procesit të ndërtimit meremetimit apo demolimit të objekteve, nga hapësirat private dhe publike.
- Gjeneruesi i mbeturinave ndërtimore gjatë ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, obligohet ta vendos kontejnerin e veçantë, varësisht nga sasia e mbeturinave në hapësirën e vet punuese, si dhe të njoftojë njësinë e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Ferizajt për zbrazjen e kontejnerit kur mbushet brenda afatit të caktuar.
- Caktimi i tarifës së këtij shërbimi bëhet në bazë së zbrazjes së kontejnerëve.
9. Ndërmarrjet industriale obligohen që Komunës së Ferizajt t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave që i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
10. Çdo gjenerues duhet të bashkëpunojë me autoritetin publik dhe operatorin për të siguruar një mjedis të Pastër.

NENI 9

TAKSA MBI MBETURINAT

1. Faturimi i taksës së mbeturinave bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues.
2. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave për çdo muaj të vitit.

Neni 10

KUSHTËZIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT

1. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 3 fatura të njëpasnjëshme komuna aplikon masa administrative ndaluese për shërbimet të cilat ofrohen nga drejtoritë e komunës:
 - a. Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ)
 - b. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit (DUM)
 - c. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (DSHPE)
 - d. Zyra e Prokurimit (ZP)

- e. Drejtoria e Financave (DF)
- g. Sektori për inspektim (SI)
- 2. Taksa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për të gjitha kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave (amvisërite, bizneset, institucionet publike dhe bizneset e shkallës së lartë), përcaktohet sipas tabelës në shtojcën A
- 3. Shkalla e tarifës do të rishikohet nga Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Emergjencave çdo dy vjet në muajin Qershor.

Neni 11

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITE E OPERATORËVE TË KONTRAKTUAR PËR MENAXHIMIN DHE TRANSPORTIMIN E MBETURINAVE

1. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

Neni 12

VEPRIMET E NDALUARA

1. Në bazë të kësaj regulloreje ndalohen veprimet si më poshtë:
 - a. Hedhja e mbeturinave ndertimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise Publike dhe private;
 - b. Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;
 - c. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave etj;
 - d. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;
 - e. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
 - f. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike dhe private (në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike-private;
 - g. Ndërrimi i vend ndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
 - h. Djegia e mbeturinave në vende publike dhe private, kontejnere apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
 - i. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;
 - j. Shfrytëzimi i kontejnerëve publikë nga bizneset, veprimtarite ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në perkufizimin e mbeturinave komunale dhe komerciale;
 - k. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paaautorizuar;
 - l. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
 - m. Dërdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në

- impianetet per trajtim apo për deponim ne deponi të mbeturinave;
- n. Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shperndarjes apo rjedhjes së mbeturinave gjate transportit me destinacion tek impiantetet per trajtim apo në deponi të mbeturinave;
 - o. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjise së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër;
 - p. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre, rruge, parqe e hapësira të tjera publike dhe private pa njoftim paraprak nga komuna për orarin-kohën e hedhjeve të këtyre mbeturinave.

Neni 13

DISPOZITAT NDËSHKUESE – GJOBAT

- 1. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbauesve privat.
- 2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregullore, Inspektori komunal shqipton gjobë mandatore sipas udhëzimit administrative 14/2015, apo gjobat tjera të percaktuara sipas Ligjit për mbeturina.

Neni 14

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

- 1. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këte rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi.
- 2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunes, Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjencave dhe njësite perkatese të administrates komunale.
- 3. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Sektori i Inspektionit dhe zyrtarët e tjerë të autorizuar nga ana e komunës së Ferizajt.
- 4. Me këtë rregullore duhet të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Financave.
- 5. Shtojca A- tarifat / taksat e shërbimit pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore duhet të inkorporohen në rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa.

Neni 15

HYRJA NE FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

SHTOJCA / A – Tarifat / taksat e shërbimit

Ligji për mbeturina nr. 04/L-060, neni 15 ku përcaktohet përgjegjesit dhe detyrat e komunës, në paragrafin 1.8 parashihet që komuna cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale. Andaj në bazë të këtij ligji, i mundësohet kuvendit të komunës së Ferizajt që të marrë në shqyrtim ndryshimin e tarifave, po ashtu Ligji për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, ja mundëson kuvendit të komunës të merr vendime të tilla. Andaj duke u bazuar në këto ligje, më poshtë po listojmë propozimin tonë lidhur me ndryshimin e tarifave / taksave për kryerjen e shërbimeve të mbeturinave.

Kategoritë e klientëve	Propozimi për çmim të ri (pa TVSH)	Propozimi për çmim (me TVSH)
<u>Amvisëritë</u> (Të rregullta)	8.39 €	9.90 €
<u>Amvisëritë</u> (Mërgata – Faturë PAUSHALLE)	4.63 €	5 €
<u>Tarifë Fikse</u>	1 €	1.18 €
<u>Bizneset me tarifa - kat. 1</u>	13.80 €	14.90 €
<u>Bizneset me tarifa - kat. 2</u>	21.20 €	22.9 €
<u>Bizneset me tarifa - kat. 3</u>	36.02 €	38.9 €
<u>Bizneset me kontratë 1.1 m³</u>	23.98 €	25.9 €
<u>Bizneset me kontratë 5.0 m³</u>	101.76 €	109.9 €
<u>Institucionet me kontratë 1.1 m³</u>	23.98 €	25.9 €
<u>Institucionet me kontratë 5.0 m³</u>	101.76 €	109.9 €
<u>Bizneset me tarifa - kat. 4</u>	111.05 €	119.9 €
<u>Kategori e veçantë - kat. 5</u>		<u>Vlera e Tarifës - E papërcaktuar</u> Tarifa caktohet nga Kompania e Licencuar për Grumbullimin dhe Bartjen e Mbeturinave

Data: 00.00.2026